



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS
Mbledhje Rradhës
Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E ENJTE, DATA 28.01.2021, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RRADHËS NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR
2. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE ME FONDE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË DURRËS PËR MUAJIN JANAR 2021
3. Shqyrtim dhe	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT Z.ARBEN ISAKU

miratim i projekt-vendimit të këshillit	
4. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË TRE OBJEKTEVE BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 3 DHE NR. 4, DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS TË THELLUAR, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË
5. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR E PALLATEVE PRANË TYRE, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
6. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHËMBJES SË BANESAVE TË TYRE (PALLATE), SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
7. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR. 599, DATË 11.03.2019 “PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT VJETOR PREJ 8.800.000 LEKË PËR PROKURIMIN E SIPËRMARRJES PRIVATE TË SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES DHE RUAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË DURRËSIT”
8. Relatim Këshilltarëve	RAPORT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS PËR 12-MUJORIN E VITIT 2020
9. Relatim nga Komisioni i BGJMS	RELATIM MBI REZOLUTËN “MBI MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR SI REZULTAT I PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19, PËR PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE”, E CILA ËSHTË MIRATUAR ME VKB NR.58, DATË 30.06.2020
10. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E KONTRATËS MODEL PËR KALIMIN E MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019 SIPAS PROJEKTEVE MODEL NGA BASHKIA DURRËS TEK PËRFITUESI
Pyetje nga Këshilltarët	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet, do të jenë:

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, të nenit 33, neni 34 pika 1, neni 77 pika 8, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

DATA 27.01.2021 Pikat 1, 2, do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **11.00**

DATA 28.01.2021 Pika 3 raportohet në seance plenare nga:

- Komisioni i Mandateve

DATA 27.01.2021 Pika 4, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **12.00**

DATA 27.01.2021 Pikat 5, 6 do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **13.00**

DATA 27.01.2021 Pika 7, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **14.00**

DATA 28.01.2021 Pikat 8,9, do të raportohen në senacë plenare nga:

- Kryesia e Këshillit
- Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale

DATA 27.01.2021 Pika 10, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **15.00**

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja